

Duke qenë Shoqëri Aksionare me ofertë publike, por e pa mbështur në Fondet e Buxhetit të shtetit, struktura e pagave nuk i nënshtrohet ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, por bazohet në:

- Ligji nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.
- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 776, datë 19.12.2025, “Për miratimin e pagës minimale në shkallë vendi”;
- Vendimin e Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Nr. 11, datë 05.12.2025,

Duke qenë se marrëdhënia e punës rregullohet në bazë të Kodit të Punës, niveli i pagës përcaktohet nga Administratori i Shoqërisë, sipas disa kategorive, me vendim të Këshillit Mbikqyrës.